



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1569/8 prot

Datë 28.07.2025

V E N D I M
Nr. 963/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.07.2025, me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “O-SP Albania” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-46732- 05-02-2025, me objekt: “Blerje Filtra, Vaj Motorri, Vaj Hidrauliku, Antifrizë, Alkol Frenash Viti 2025- për nevoja të NSHP-së”, me fond limit 1,664,640.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 15-05-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.

Ankimues: Operatori ekonomik “O-SP Albania” SHPK me NIPT (M11424016S) dhe adresë: Fshati Mucaj, Vorë, me Nr.Pasurie 321/29, Zona Kadastrale 2726, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Mallakastër, me adresë: Lagja: 18 Prilli, Kodi postar 9308, Ballsh.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.05.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-46732- 05-02-2025, me objekt: “Blerje Filtra, Vaj Motorri, Vaj Hidrauliku, Antifrizë, Alkol Frenash Viti 2025- për nevoja të NSHP-së”, me fond limit 1,664,640.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 15-05-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.

II.2. Në datën 15.05.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 11.06.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "EXIMOIL" SHA, me vlerë:	976.410,00 lekë	skualifikuar
2. "O-SP Albania" SHPK SHPK, me vlerë:	1.213.909,70 lekë	skualifikuar
3. "ELBA OIL 2015" SHPK, me vlerë:	1.431.750,00 lekë	kualifikuar
4. "Sorgiena Agaj", P.F	1.518.900,00 lekë	kualifikuar
5. "BREGU COMPANY" SHPK	1.595.000,00 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 17.06.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Operatori ekonomik "O-SP Albania" SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi me arsyen si me poshte vijon:

"O.E. "O-SP Albania" sha në dokumentacionin fizik të dorëzuar në autoritetin kontraktor Bashkia Mallakastër, nuk ka paraqitur dokumentin fizik zyrtar për Operatorin Ekonomik, siç kërkohet në shkronjën "b", të nenit 26/2 mbi vetëdeklarimet e kërkuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre.

Në pikën 6 të nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet se "Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike."

Ndërkohë, në shkronjën "b", pikën 2 të nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet se "operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së."

Bazuar në bazën ligjore të sipërcituar, O.E. "O-SP Albania" sha ka pasur detyrimin të paraqesë dhe dorëzojë fizikisht tek AK Bashkia Mallakastër dëshminë e penalitetit të personit juridik "O-SP Albania" sha me NUIS M11424016S për të vërtetuar sipas shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, se "operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së". Referuar inventarit fizik dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar nga O.E. "O-SP Albania" sha, rezulton se ky OE ka dorëzuar vetëm 1 (një) dokument Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), fletë 1 (një), nr.kërkese 15, datë 03.06.2025, vetëm për administrator/aksioner z.A.M, dhe nuk ka dorëzuar Vërtetim të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për personin juridik ofertues O.E. "O-SP Albania" sha.

Në kushtet që O.E. "O-SP Albania" sha, referuar dokumentacionit fizik të inventarizuar dhe të protokolluar në autoritetin kontraktor Bashkia Mallakastër me nr.2035/7 prot., datë 04.06.2025, nuk ka dorëzuar dokumentin fizik sipas bazës ligjore të sipërcituar, atëherë ky OE nuk përmbush kriterin e përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, dhe për këtë arsye O.E. "O-SP Albania" sha skualifikohet."

II.6. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5432, datë 18.06.2025 dhe me nr. protokoll 1569/2025 datë 18/06/2025 e operatori ekonomik “O-SP Albania” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-46732-05-02-2025, me objekt: “Blerje Filtra, Vaj Motorri, Vaj Hidrauliku, Antifrizë, Alkol Frenash Viti 2025- për nevoja të NSHP-së”, me fond limit 1,664,640.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 15-05-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.

II.7. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1569/1 prot., datë 19.06.2025 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “O-SP Albania” SHPK.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se, nuk janë dorëzuar argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 2035/22 prot., datë 25.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1569/3 prot., datë 25.06.2025 me objekt “Ddërgim informacioni”, autoritetit kontraktor ka depozituar pranë KPP vendimin e KSHA lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “O-SP Albania” SHPK, dhe po të njëjtin informacion e ka dërguar edhe nëpërmjet sistemit. Referuar vendimit të KSHA-së, rezulton se kjo e fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur mos pranimin e ankesës si më poshtë vijon:

“....Në datën 11.06.2025, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka verifikuar dokumentacionin fizik të subjektit "O-SP Albania. Sh.a, e ka skualifikuar me motivacionin si më poshtë:

O.E. "O-SP Albania" sha në dokumentacionin fizik të dorëzuar në autoritetin kontraktor Bashkia Mallakastër, nuk ka paraqitur dokumentin fizik zyrtar për Operatorin Ekonomik, siç kërkohet në shkronjën "b", të nenit 26/2 mbi vetëdeklarimet e kërkuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre.

Në pikën 6 të nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet se "Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike."

Ndërkohë, në shkronjën "b", pikën 2 të nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet se "operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së."

Bazuar në bazën ligjore të sipërcituar, O.E. "O-SP Albania" sha ka pasur detyrimin të paraqesë dhe dorëzojë fizikisht tek AK Bashkia Mallakastër dëshminë e penalitetit të personit juridik "O-SP Albania" shpk

Në kushtet që O.E. "O-SP Albania" sha, referuar dokumentacionit fizik të inventarizuar dhe të protokolluar në autoritetin kontraktor Bashkia Mallakastër me nr.2035/7 prot., datë 04.06.2025, nuk ka dorëzuar dokumentin fizik sipas bazës ligjore të sipërcituar, atëherë ky OE nuk përmbush kriterin e përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, dhe për këtë arsye O.E. "O-SP Albania" sha skualifikohet.

III Konkluzion

Personi për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura sipas ankesës së paraqitur nga "O-SP ALBANIA" SH.A.,

Arsyeton:

III.1. Në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, pritet të shprehet se:

"Operatori ekonomik nuk është i detyruar të mos veprojë penalisht, të parashikuar në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së."

Në bazë të legjislacionit të lartë, subjekti "O - SP- Albania" sh.a. ka të drejtë të përcaktojë rregullat e parapërgatitjes së dokumentacionit "Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore të Operatorit Ekonomik pranë Autorizimit të Kontraktorit dhe nuk ka kriteret të përcaktuara dhe nuk ka të drejtë të kualifikohet me të drejtë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Pra, pretendimet e operatorit ekonomik sipas kërkesës nuk qëndrojnë.

Përfundimisht, baza në nenin 114 të Ligjit nr. 162/2022 "Për Prokurimin Publik", datë 23.12.2020, si dhe në përmbushjet e bëra në nenin 102 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, persona të autorizuar për shqyrtimin e ankesës,

Vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "O-SP Albania" SH.A për procedurën e prokurimit të sipërcituar."

II.10. Me shkresën nr. 1569/4 prot, datë 16.07.2025, është përcjellë tek autoriteti kontraktor kërkesa për informacion nga Komisioni i Prokurimit Publik, lidhur me dorezimin e te gjithë dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik "O-SP Albania" SHPK për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "O-SP Albania" SHPK.

II.11. Me shkresën nr. 2035/24 prot, datë 22.07.2025 protokolluar me nr.1569/5 datë 24.07.2025, është përcjellë nga autoriteti kontraktor informacion i kërkuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, lidhur me dorezimin e te gjithë dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik "O-SP Albania" SHPK për trajtimin e ankesës së sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ankimues “O-SP Albania” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tyre duke argumentuar se : *“vetë LEGJISLATORI ka parashikuar referuar konkretisht Neni 82,pika 2 të ligjit nr. 162/2020 ipër prokurimin publikë i ndryshuar dhe Neni 26 pika 7 të Vendimit të këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktojn se në çdo rast Autoriteti Kontraktor,në cdo kohë gjatë procedurës,nëse ka ka paqartësi apo është i dyjësuar lidhur me plotësimin e ndonjë kriteri,mund tii kërkojë sqarime Operatorit Ekonomik. Duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën Autoritetit Kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomike. Gjë të cilën Autoriteti Kontraktor në fjalë jo vetëm që nuk e ka bërë,por apriori ka skualifikuar oferten e shoqerise tone. Fakti që AK nuk ka shfrytëzuar këtë të drejtë-ligjore e njëkohësisht detyrim procedural, përbën një cenim të parimit të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik. Per sa thuhet me lart ,arsya e refuzimit te ofertes se operatorit ekonomik io-SP Albaniaë sh.a nuk qendrojn. Nenvijejojme faktin qe ,ne si operator ekonomik pjesmarres ne kete procedure prokurimi ,per sa kerkohet ne DST e publikuar nga AK ,i plotesojme te gjitha kushtet dhe kriteret e vendosura,per kete kontrate publike”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 1/c dhe 1/ç “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret kualifikuese, si më poshtë vijon:

1. “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

[...]

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

III.1.2. Në shtojcën 8/2 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 1/a “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;”

III.1.3. Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit, është parashikuar si më poshtë vijon:

[...]

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata				
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.				
Sqarime	nëse	vlerësohet	e	nevojshme

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të shtojcës 9 të mesipërm të dokumentave të tenderit për procedurën objekt ankimi, rezulton se ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit

Ndërsa nga shqyrtimi i dokumentacionit fizik shoqerues të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të shtojcës 9 të mesipërm të dokumentave të tenderit për procedurën

objekt ankimi, sipas shkresës nr.2035/24 datë 22.07.2025 protokolluar me tonën 1569/5 datë 24.07.2025, rezulton se ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Vërtetim për pagim kontributesh për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
- Ekstrakt i thjeshtë.
- Status aktiv.
- Certifikatë regjistrimi.
- Vërtetim pagim detyrimesh.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- Vërtetim për shlyerjen e taxave dhe tarifave vendore (Bashkia Vorë)
- Vërtetim debie OSSHE+Kontratë Qiraje+Deklaratë

III.1.4. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre; b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.” Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.1.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të*

lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; **b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;** c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi¹⁹; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 20të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi; l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfutues në regjistrin e pronarëve përfutues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërket të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërket të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë

në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.6. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. Në nenin 76 pika , pika 1, e ligjit 162/2020 të LPP-së përcaktohet se: “3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

“1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.”

III.1.8. Në nenin 77 pika 1 të ligjit 162/2020 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur

duhet të vërtetohet se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetohet se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik "OS-P Albania" SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, A, parashikohet "Deklaratë Për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme". Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik "OS-P Albania" SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik "OS-P Albania" SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues "OS-P Albania" SHPK, për skuafikimin e ofertës së tij, me anë të shkresës nr. 1569/4 prot., datë 16.07.2025, i kërkoj autoriteti kontraktor, në mbështetje të nenit 82, pika 5, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik "OS-P Albania" SHPK, i renditur i pari. Me anë të shkresës nr. 2035/24 prot., datë 22.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1569/5 prot datë 24.07.2025, me objekt "Kthim përgjigje", autoriteti kontraktor, ka paraqitur pranë KPP-së, dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik "OS-P Albania" SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se operatori ekonomik ankimues "O-SP Albania" SHPK, nga verifikimet e kryera nga dokumentacioni i dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike si dhe pranë autoritetit kontraktor konstatohet, se operatori ekonomik, ka dorëzuar 1- Shtojcën 9, "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" -Vërtetim për pagim kontributesh për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, Ekstrakt i thjeshtë, Status aktiv, Certifikatë regjistrimi, Vërtetim pagim detyrimesh, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, Vërtetim

për shlyerjen e taxave dhe tarifave vendore (Bashkia Vorë), Vërtetim debie OSSHE+Kontratë Qiraje+Deklaratë. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e sipërcituar të dorëzuar konstatohet, se bazuar në nenin 26 të VKM Nr 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ligjvënësi ka kërkuar dokumentacion provues lidhur me piken b të nenit 26 ku kërkohej b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së, sipas pikës 6 të nenit 26 “6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”. Nga verifikimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se operatori ekonomik në fjalë nuk ka dorëzuar këtë dokument pranë AK, gjithashtu edhe nga Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit verifikohet mos plotësimi i saj për këtë rubrikë duke mos dhënë asë indicien për informacionin i cili mund të gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, që duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. Nga sa më sipër rezulton se ky operatorë nuk ka paraqitur vërtetimin që operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nga ku mund të konstatohet që operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale. Gjithashtu theksojmë se vendosja e kriterëve të kualifikimit ka si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Komisioni vëren, se operatori ekonomik “O-SP Albania” SHPK nuk ka dorëzuar Vërtetimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për operatorin ekonomik/ subjektin që nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP. Sa më lart KPP gjykon se operatori ekonomik “O-SP Albania” SHPK nuk ka plotësuar as rubrikën Pjesa II Shkaqet e përjashtimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit duke mos dhënë as informacionin që ky formular kërkon, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për këtë kriter si në sistemin e prokurimeve elektronike ashtu dhe pranë autoritetit kontraktor referuar informacionit të këtij të fundit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave

nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “O-SP Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-46732- 05-02-2025, me objekt: “*Blerje Filtra, Vaj Motorri, Vaj Hidrauliku, Antifrizë, Alkol Frenash Viti 2025- për nevoja të NSHP-së*”, me fond limit 1,664,640.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 15-05-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.
 2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kalimin e tarifës financiare në buxhet të shtetit, të paguar nga operatori ekonomik ankimues “O-SP Albania” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

